



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës
Tužilački Savet Kosova
Kosovo Prosecutorial Council

Plani i Punës 2018



Tabela e Përmbajtjes

I.	Pjesa e parë	3
1.	Përmbledhje Ekzekutive	3
2.	Vizioni	4
3.	Misioni	4
4.	Vlerat	4
5.	Baza ligjore dhe përbërja	5
6.	Detyrat dhe kompetencat e Këshillit	5
II.	Pjesa e dytë	6
1.	Objektivat e Këshillit Prokurorial të Kosovës	6
I.	Fuqizimi i administrimit, menaxhimit dhe llogaridhënies në Këshill	6
II.	Mbikëqyrja sistematike e sistemit prokurorial	7
III.	Rritja e numrit të prokurorëve të shtetit	7
IV.	Transferimi dhe avancimi i prokurorëve	8
V.	Forcimi i sistemit të vlerësimit të performancës së prokurorëve	8
VI.	Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të disiplinimit të prokurorëve	8
VII.	Zbatimi i sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve (TIK/SMIL)	8
VIII.	Krijimi i modelit për menaxhimin e proceseve të punës në sistemit prokurorial	9
IX.	Rritja e aftësive profesionale të prokurorëve dhe personelit administrativ.....	9
X.	Avancimi i komunikimit me publikun dhe media	10
XI.	Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknologjisë informative dhe komunikimit	10
XII.	Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet e vendit dhe ndërkombëtare.....	10
2.	Objektivat e Sekretariatit të Këshillit	12
I.	Fuqizimi i departamenteve të Sekretariatit të Këshillit	12
II.	Transferimi dhe avancimi i personelit administrativ	12
III.	Rekrutimi i personelit administrativ	12
IV.	Vlerësimi i performancës së personelit administrativ	13
V.	Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit	13
VI.	Mbikëqyrja e shërbimeve të ofruara nga administrata e shërbimeve të sistemit prokurorial	13
3.	Objektivat e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive	14
I.	Mbështetja e vazhdueshme e Këshillit në administrimin e prokurorive	14
II.	Mbështetja e vazhdueshme në procesin e rekrutimit, emërimit, rëmërimit, transferimit, avancimit dhe vlerësimit të performancës të prokurorëve	14
III.	Avancimi i sistemit të të dhënave statistikore	15
IV.	Avancimi i vlerësimit të nevojave për trajnime dhe koordinimit të pjesëmarrjes së prokurorëve në trajnim	15



I. Pjesa e parë

1. Përmbledhje Ekzekutive

Këshilli Prokurorial i Kosovës me qëllim të zbatimit të planit strategjik 2016 – 2018 dhe në funksion të ushtrimit të mandatit ligjor nxjerrë planin vjetor të punës.

Plani i punës për vitin 2018 përmban pjesën hyrëse ku përshkruhet mandati dhe struktura organizative e Këshillit Prokurorial të Kosovës (Këshilli), me theks të veçantë në vizionin dhe misionin e tij.

Pjesa e dytë e planit i përcakton objektivat e Këshillit për vitin 2018, objektiva këto specifike, të matshme dhe të arritshme. Plani përfshinë edhe objektivat dhe aktivitetet e Sekretariatit të Këshillit dhe të Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorisë (NJSHP).

Pjesa e tretë e planit i konkretizon objektivat përmes aktiviteteve, indikatorëve, organeve përgjegjëse dhe afateve kohore.

Miratimi i një plani të punës si ky i cili është bazuar në standarde të njohura për hartimin e planeve, me siguri se do të mundësojë zhvillimin më të lehtë të aktiviteteve të përcaktuara paraprakisht, por do të krijojë mundësi që veprimet e Këshillit lidhur me sigurimin e kushteve dhe ofrimin e shërbimeve për Prokurorin e Shtetit të jenë të nivelit sa më të lartë. Monitorimi dhe mbikëqyrja e realizimit të politikave dhe vendimeve të Këshillit, përmes një planifikimi si në këtë plan, do të jetë më e lehtë të zbatohet gjithashtu.

Me rastin e hartimit të këtij plani, Këshilli ka parasysh sfidat që mund të paraqiten e të cilat kanë të bëjnë me mundësinë e ndryshimeve ligjore, nevojën për ndryshimin e akteve nënligjore si dhe resurset buxhetore dhe kapacitetet njerëzore.

Përfundimisht, Këshilli ka parasysh edhe pritjet për mbështetje të donatorëve dhe partnerëve të tij në realizim të këtij plani.



2. Vizioni

Vizioni i Këshillit është puna e vazhdueshme për arritjen e standardeve dhe vlerave të larta të profesionalizmit, llogaridhënies, integritetit, ndershmërisë dhe transparencës në sistemin prokurorial të Kosovës, përmes politikbërjes vendimmarrjes të cilat sigurojnë pavarësinë, paanshmërinë dhe efikasitetin e tij.

3. Misioni

Misioni i Këshillit është sigurimi i një sistemi efikas dhe efektiv të hetimit dhe ndjekjes penale nga prokurorë të rekrutuar në bazë të meritës, të vlerësuar në bazë të rezultateve në punë dhe të mbikëqyrur sipas standardeve të larta si dhe ofrimi i resurseve adekuate humane dhe infrastrukturore.

4. Vlerat

Si institucion i pavarur, Këshilli karakterizohet nga vlerat si në vijim:

- Realizimi i mandatit në mënyrë të pavarur dhe pa ndërhyrje nga jashtë;
- Garantimi i përfaqësimit gjithëpërfshirës dhe respektimit për diversitetin;
- Posedimi i kapaciteteve funksionale për zhvillim të politikave dhe strategjive;
- Të qenit transparent në vendimmarrje;
- Promovimi i qasjes së barabartë në shërbimet e sistemit prokurorial për të gjithë pa dallim;
- Realizimi i detyrave dhe mandatit në bazë të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- Avancimi i vazhdueshëm i sistemit të administrimit dhe menaxhimit;
- Promovimi i bashkëpunimit dhe respektimi i standardeve ndërkombëtare lidhur me planifikimin dhe llogaridhënien dhe
- Ofrimi i shërbimeve profesionale, efikase, efektive dhe bazuar në ligj.



5. Baza ligjore dhe përbërja

Këshilli është i themeluar me Ligjin Nr. 03/L- 224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës. Nga 1 janari i vitit 2016, sipas Ligjit për Plotësim Ndryshimin e Ligjit Nr. 03/L- 224 për Këshillin Prokurorial të Kosovës (Ligji Nr. 05/L-035), Këshilli përbëhet nga trembëdhjetë (13) anëtarë, dhjetë (10) prej të cilëve janë prokurorë, ndërsa tre (3) anëtarë jo prokurorë. Me bazën aktuale ligjore Këshilli përbëhet nga:

- Kryeprokurori i Shtetit sipas detyrës zyrtare (ex officio);
- Shtatë (7) anëtarë prokurorë, një (1) nga çdo prokurori themelore;
- Një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria e Apelit;
- Një (1) anëtar prokuror nga Prokuroria Speciale;
- Një (1) anëtar avokat nga Oda e Avokatëve të Kosovës;
- Një (1) anëtar, profesor universitar i fakulteteve juridike dhe
- Një (1) anëtar, përfaqësues nga shoqëria civile.

Këshilli udhëhiqet nga Kryesuesi i cili zgjidhet nga radhët e anëtarëve prokurorë të Këshillit, me mandat tre (3) vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

Kryesuesi i Këshillit paraqet raporte publike vjetore së paku një herë në vit për performancën, veprimet, koston dhe nevojat buxhetore të sistemit prokurorial si dhe organizon procedurën e zgjedhjes së anëtarëve të komisioneve të përhershme sipas këtij ligji, duke i mundësuar Këshillit një proces transparent dhe të përgjegjshëm të propozimeve dhe emërimit të tyre.

6. Detyrat dhe kompetencat e Këshillit

Përgjegjësitë kryesore të Këshillit janë si në vijim:

- Siguron që prokurorët të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së funksioneve të tyre;
- Rekruton dhe propozon te Presidenti kandidatët për emërim dhe riemërim për prokurorë, përfshirë Kryeprokurorin e Shtetit;
- Vlerëson, ngrit në detyrë, disiplinon, propozon shkarkimin, transferon dhe ofron mbështetje për trajnimin e prokurorëve;
- Në bashkëpunim në Akademinë e Drejtësisë, themelon standardet për rekrutimin, organizimin dhe shpalljen e provimit përgatitor për kualifikimin e prokurorëve;
- Në bashkëpunim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit zhvillon politikat dhe strategjitë prokuroriale për luftimin efektiv të kriminalitetit;
- Në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit bën përgatitjen dhe mbikëqyrjen e buxhetit të sistemit prokurorial.



II. Pjesa e dytë

1. Objektivat e Këshillit Prokurorial të Kosovës

Këshilli synim kryesor ka ngritjen e vazhdueshme të efikasitetit dhe efektivitetit në orientimin e politikave dhe planeve strategjike të sistemit prokurorial. Ky synim do të realizohet përmes analizave të vazhdueshme të funksionimit të sistemit prokurorial në bashkëpunim të ngushtë me Prokurorin e Shtetit duke përcaktuar aktivitete të detajuara, të matshme dhe afatshme për zbatimin e këtyre politikave dhe planeve strategjike. Ky synim do të realizohet përmes zbatimit të detyrave dhe objektivave të përcaktuara nga Këshilli për vitin 2018, si në vijim:

- Fuqizimi i administrimit, menaxhimit dhe llogaridhënies;
- Mbikëqyrja sistematike e sistemit prokurorial;
- Rritja e numrit të prokurorëve të shtetit;
- Zhvillimi i karrierës prokurorëve të shtetit;
- Forcimi i sistemit të vlerësimit të performancës së prokurorëve;
- Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të disiplinimit të prokurorëve;
- Zbatimi i sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve;
- Krijimi i modelit për menaxhimin e proceseve në sistemin prokurorial;
- Ngritja e kapaciteteve të administratës së sistemit prokurorial (rititja e numrit dhe zhvillimi i tyre profesional);
- Rritja e aftësive profesionale të prokurorëve dhe personelit administrativ;
- Avancimi i komunikimit me publikun dhe media;
- Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe të teknologjisë informative;
- Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet e vendit dhe ndërkombëtare;

I. Fuqizimi i administrimit, menaxhimit dhe llogaridhënies në Këshill

Me qëllim të administrimit dhe menaxhimit më efikas dhe më llogaridhënës të zyrave të prokurorive në Kosovë, Këshilli synon që të vazhdojë me miratimin e akteve nënligjore, politikave, vendimeve dhe planeve strategjike. Për më tepër, Këshilli tashmë ka krijuar praktika efikase për rekrutimin e prokurorëve, disiplinimin dhe vlerësimin e performancës së tyre dhe këto praktika do të avancohen edhe më tej në vitin 2018. Këshilli do të vazhdojë me përmirësimin e kushteve të punës për prokurorët dhe personelin administrativ në mënyrë që këta funksionet t'i ushtrjnë të pavarur, me profesionalitet dhe të paanshëm.



Pas konsolidimit të bazës ligjore të Komisioneve të përhershme, planifikohet një dinamikë edhe më intenzive e punës së komisioneve të përhershme dhe komisioneve ad hoc, me të cilat do të mbikëqyret zbatimin e vendimeve të Këshillit, përmes raportimeve periodike të këtyre komisioneve në Këshill.

Në pajtim me Rregulloren për Veprimtarinë e Këshillit, Këshilli në vitin 2018 do të mbajë takime bazuar në nevojat dhe dinamikën e përcaktuar nga vet Këshilli, komisionet e tij dhe Prokurori i Shtetit.

Gjithashtu, me qëllim të avancimit të sistemit të planifikimit dhe shpenzimit të buxhetit, planifikimit dhe shpërndarjes së drejtë të burimeve njerëzore dhe ofrimit të shërbimeve të nevojshme, Këshilli me ndihmën e Sekretariatit dhe Prokurorit të Shtetit do të marr vendime në funksion të një administrimi dhe menaxhimi më të avancuar dhe llogaridhënës.

II. Mbikëqyrja sistematike e sistemit prokurorial

Komisionet që funksionojnë në kuadër të Këshillit në planet e tyre të punës për vitin 2018 do të sigurohen që prioritetet e planifikuara nga Këshilli të realizohen brenda afateve kohore. Në këtë drejtim, komisionet do të monitorojnë zbatimin e ligjeve, akteve nënligjore dhe politikave të Këshillit në sistemin prokurorial, rekrutimin, transferimin, avancimin si dhe zbatimin e vendimeve për masat disiplinore. Komisionet për më tepër do të mbikëqyrin përgatitjen e kërkesës buxhetore dhe procesin e rishikimit buxhetor përfshirë zbatimin e programeve trajnuese për prokurorë pas vlerësimit të performancës së prokurorëve. Një rol aktiv në procesin e monitorimit të strategjive, politikave dhe vendimeve të Këshillit pritet të ketë Sekretariati i Këshillit dhe Njësi për Vlerësimin e Performancës së Prokurorisë. Këshilli mund të formojë grupe pune për të arritur qëllimet e caktuara nga kjo objektivë.

III. Rritja e numrit të prokurorëve të shtetit

Gjatë vitit 2018, Këshilli planifikon të rekrutojë 10 prokurorë të rinj. Këtij procesi i paraprin analiza për numrin e nevojshëm të prokurorëve. Kjo analizë mbështetet në numrin e kallëzimeve penale të pranuar në punë, normën e prokurorëve, proceseve të avancimit dhe transferimit si dhe pozitat që lirohen nga pensionimi i prokurorëve dhe kapaciteteve buxhetore.

Këshilli do të sigurojë që ky proces të zhvillohet sipas parimeve të konkurrencës, meritës, profesionalizmit, transparencës dhe konfidencialitetit të plotë ashtu siç parashihet në Rregulloren për Rekrutimin e prokurorëve.

IV. Transferimi dhe avancimi i prokurorëve

Zhvillimi i karrierës në sistemin prokurorial mbetet njëra ndër objektivat kryesore të Këshillit. Sipas këtij objekti, gjatë vitit 2018, pas analizës së nevojave nëpër nivele të prokurorive të ndryshme dhe departamenteve, Këshilli në konsultim me institucionin e Prokurorit të Shtetit do të zhvillojë procese për avancimin dhe transferimin e prokurorëve. Të gjitha këtyre proceseve pritet tu paraprijë planifikimi paraprak dhe vendimet paraprake nga Këshilli.

V. Forcimi i sistemit të vlerësimit të performancës së prokurorëve

Në pajtim me rregullativën ligjore, Këshilli do të vazhdojë rritjen e mëtutjeshme të procesit të vlerësimit të performancës së prokurorëve. Synim i Këshillit është që vlerësimi i performancës së prokurorëve të jetë pozitivisht i orientuar dhe të ndikojë në rritjen e llogaridhënies dhe profesionalizmit të prokurorëve dhe në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të tyre.

Për më tepër, Këshilli do vazhdojë avancimin e politikave dhe standardeve të vlerësimit të performancës së prokurorëve për t'u siguruar që prokurorët me performancë të dobët të udhëzohen për trajnime adekuate në Akademinë e Drejtësisë të Kosovës. Një vlerësim i kriterëve dhe procedurave aktuale do t'i nënshtrohet një vlerësimi adekuat nga ana e Këshillit dhe komisioneve të tij.

VI. Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të disiplinimit të prokurorëve

Këshilli do të vazhdojë me politika të cilat sigurojnë procedura transparente dhe profesionale të disiplinimit të prokurorëve. Veprimet e tij Këshilli planifikon t'i realizojë në mënyrë efikase duke krijuar mekanizma përkatës në mbështetje të Komisionit Disiplinor por edhe duke ofruar udhëzime adekuate për prokurorë në varësi të situatave kur ata janë apo mund të jenë të përfshirë në shkelje disiplinore.

Këshilli do të përcjellë me vëmendje zhvillimet legjislative përkitazi me përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve dhe karshi këtyre zhvillimeve do të hartojë politika, akte nënligjore dhe ndërmerr vendimet adekuate.

VII. Zbatimi i sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve (TIK/SMIL)

Ka kohë që kur sistemi elektronik i menaxhimit të lëndëve i njohur si TIK/SMIL është përcaktuar si një ndër projektet më serioze dhe prioritare të sistemit prokurorial. Aktualisht po punohet intensivisht nga stafi, prokurorët dhe ekspertët (vendor dhe të jashtëm) që sistemi për menaxhimin e lëndëve



të jetë gati për tu aplikuar edhe në Prokurorin e Shtetit. Viti 2018 është vit vendimtar për futjen në funksion të këtij sistemi, prandaj Këshilli do të hartojë një agjendë intesive të punëve dhe veprimeve të cilat do t'i ndërmerr përgjatë këtij viti në mënyrë që prokurorët dhe personeli përgjegjës të zbatojnë pa hezitim këtë sistem.

VIII. Krijimi i modelit për menaxhimin e proceseve të punës në sistemit prokurorial

Këshilli me qëllim të përmirësimit të punës dhe efikasitetit të sistemit prokurorial planifikon të krijojë modelin e menaxhimit të proceseve të punës. Në vitin 2018 ky model do të aplikohet në fushën e buxhetit, financave dhe shërbimeve të përgjithshme. Modeli do të përcaktojë definicionet, përshkrimet dhe ndërveprimet e proceseve kryesore dhe nën proceseve që derivojnë. Për më tepër, do të përcaktohen përgjegjësitë dhe masat e cilësisë përfshirë vlerësimet e performancës dhe mundësitë për përmirësim.

IX. Rritja e aftësive profesionale të prokurorëve dhe personelit administrativ

Rritja e shkathtësive dhe aftësive profesionale të prokurorëve dhe personelit administrativ do të vazhdojë të jetë prioritet i Këshillit edhe për vitin 2018. Në këtë kuadër, në bashkërendim me Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Akademinë e Drejtësisë të Kosovës, Këshilli do të punojë në hartimin e një plani ambicioz orientues të trajnimit për prokurorët për vitin 2019. Ky plan do të jetë i bazuar në politikën e trajnimit të miratuar nga Këshilli.

Këshilli do të angazhohet në avancimin e mëtutjeshëm të njohurive dhe ngritjen e shkathtësive të prokurorëve dhe personelit administrativ në mënyrë që të jenë më efikas, efektiv, etik dhe profesional në punën e tyre.

Këshilli në bashkëpunim me Prokurorin e Shtetit dhe Akademinë e Drejtësisë të Kosovës do të fuqizojë Zyrën për Koordinimin e Trajnimeve në kuadër të NJSHP me qëllim të mbikëqyrjes më rigoroze të zbatimit të programeve trajnuese dhe ndikimit të tyre te prokurorët dhe personeli administrativ.

Këshilli do të sigurohet që prokurorët e departamenteve të specializuara të ndjekin trajnimet adekuate.



X. Avancimi i komunikimit me publikun dhe media

Këshilli gjatë vitit 2018 do t'i kushtojë kujdes veçanërisht avancimit të strukturave brenda sistemit prokurorial që merren me raportet me publikun dhe median dhe promovimin e punës së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit.

Për të arritur këtë synim, Këshilli do të rekrutojë zyrtarët për media që do të merren ekskluzivisht me përmirësimin e raporteve dhe punës së sistemit prokurorial me publikun dhe mediat. Pas rekrutimit të zyrtarëve, të njëjtit do të trajnohen nga organizata profesionale si Akademia e Drejtësisë, IKAP dhe të ngjajshme për marrëdhëniet me publikun, strategjinë e komunikimit dhe teknikat e promovimit të punës së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit. Në kuadër të këtij objekti, rol të rëndësishëm do të luaj edhe zbatimi i strategjisë së sistemit prokurorial e përgatitur në vitin paraprak.

Me qëllim të sigurimit të qasjes së publikut në informacion Këshilli do të vazhdojë me mbajtjen e takimeve të hapura për publikun dhe mediat si dhe do të ofrojë informata me interes për publikun përmes broshurave, buletinit mujor dhe faqeve zyrtare.

XI. Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe teknologjisë informative dhe komunikimit

Këshilli do të vazhdojë përmirësimin e infrastrukturës fizike, të teknologjisë informative dhe të komunikimit në vitin 2018, me qëllim të ofrimit të kushteve optimale për punën e prokurorëve dhe personelit mbështetës.

Gjatë vitit 2018, Këshilli do të angazhohet që të përfundojë ndërtimi i objektit të prokurorisë për Prokurorinë Themelore të Gjakovës.

Këshilli, për më tepër, do të renovojë objektin e PSRK-së, përkatësisht vendosja e dritareve dhe sistemit të ngrohjes dhe klimatizimit, ndërsa lidhur me sigurimin e objektit permanent për Këshillin dhe Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit do të ndërmerren veprimet e nevojshme.

Gjithashtu, Këshilli do të zbatojë softuerin për administrimin më efikas të sistemit të logjistikës, përkatësisht mjeteve transportuese të sistemit prokurorial të Kosovës. Po ashtu, do të zbatojë softuerin për menaxhimin elektronik të dosjeve të prokurorëve.

XII. Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet e vendit dhe ndërkombëtare

Këshilli do të vazhdojë rritjen e bashkëpunimit me institucionet shtetërore të Republikës së Kosovës si dhe me të gjitha organizatat vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të realizimit të objektivave të tij.



Bashkëpunim më të thellë Këshilli do të mbajë me Kuvendin e Kosovës, Qeverinë e Kosovës, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Akademinë e Drejtësisë të Kosovës, Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Integritimit Evropian, Ministrinë e Administratës Publike, Odën e Avokatëve të Kosovës, Policinë e Kosovës dhe organet tjera publike të Kosovës.

Këshilli do të rrisë bashkëpunimin me organizatat donatore dhe partnerët ndërkombëtar. Në këtë drejtim përmes takimeve koordinuese me donatorë si dhe takimeve bilaterale do të realizojmë bashkëpunim intensiv me të gjithë donatorët dhe partnerët të cilët mbështesin sistemin prokurorial si dhe ato që ofrojnë mbështetje për sektorin e drejtësisë.

Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet zbatimit të projekteve aktuale me donatorë si dhe propozimi i projekteve të reja përmes të cilave do të ngritën kapacitetet e Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit në drejtim të aplikimit të standardeve më të larta ndërkombëtare në realizim të mandatit tonë. Për më tepër, Këshilli do të ofrojë resurset e veta edhe në drejtim të përmbushjes së detyrimeve që dalin nga proceset e integritimit evropian dhe çfarëdo obligimi tjetër shtetëror.

2. Objektivat e Sekretariatit të Këshillit

Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës është themeluar për të ndihmuar dhe zbatuar rregullat, rregulloret dhe politikat e Këshillit, lidhur me menaxhimin, buxhetin dhe administrimin e prokurorive. Sekretariati i propozon Këshillit politika të reja, rregulla dhe rregullore çdo herë që është e nevojshme për administrim efikas dhe efektiv të prokurorive. Për të realizuar mandatin e tij, për vitin 2018 sekretariati ka përcaktuar objektivat si në vijim:

- Fuqizimi i departamenteve të Sekretariatit të Këshillit;
- Transferimi dhe avancimi i personelit administrativ;
- Rekrutimi i personelit administrativ;
- Vlerësimi i performancës së personelit administrativ
- Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit
- Mbikëqyrja e shërbimeve të ofruara nga administrata e shërbimeve të sistemit prokurorial.

I. Fuqizimi i departamenteve të Sekretariatit të Këshillit

Sekretariati do të angazhohet në fuqizimin e departamenteve përmes zbatimit të procedurave standarde të veprimit për të gjitha funksionet dhe veprimtaritë e administratës së Këshillit. Për më tepër do të forcohen kapacitetet profesionale të personelit me qëllim të kryerjes së shërbimeve në mënyrë efikase dhe profesionale.

II. Transferimi dhe avancimi i personelit administrativ

Buxheti për sistemin prokurorial sipas projekteve për vitin 2018, mundëson realizimin e avancimeve të personelit administrativ, me çka mundësohet zhvillimi i karrierës të personelit administrativ. Në këtë drejtim, Sekretariati fillimisht do të realizojë procesin e avancimit të personelit administrativ. Sipas nevojës do të realizohet edhe procesi i transferimit. Këtyre proceseve do t'i paraprijë vlerësimi i nevojave dhe zhvillimi i planeve të veprimit ku përcaktohen afatet, veprimet dhe njësitë përgjegjëse për realizimin e tyre.

III. Rekrutimi i personelit administrativ

Mbështetur në planin për shpërndarjen e personelit dhe buxhetin e alokuar, Sekretariati do të zbatojë procedurat e rekrutimit të personelit administrativ të ri bazuar në nevojat e sistemit prokurorial.



Me qëllim të realizimit të këtij procesi me objektivitet dhe me respektim të meritokracisë, Sekretariati do të bashkëpunojë me autoritetet që e monitorojnë punën e sistemit prokurorial.

IV. Vlerësimi i performancës së personelit administrativ

Vlerësimi i performancës do të bazohet në objektivat e përcaktuara në planet individuale të secilit anëtarë të personelit. Siç parashihet në këtë plan të punës vlerësimi i rregullt bëhet në periudhën e fundit të vitit me ç'rast do të matet performanca individuale e çdo të punësuarit në administratën e sistemit prokurorial. Ky aktivitet, rrjedhimisht, do t'i shërbejë vlerësimit të përbushjes së objektivave të përgjithshme të sistemit prokurorial.

V. Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit

Me qëllim të ofrimit të shërbimeve efikase dhe efektive në sistemin prokurorial (Këshill dhe Prokuror i Shtetit), Sekretariati, krahas plotësimit të nevojave me personel, do të angazhohet në cilësinë e shërbimeve sipas planifikimeve paraprake të detajuara. Në këtë drejtim do të shfrytëzohen planet dhe Procedurat Standrade të Veprimit, resurset dhe buxheti i aprovuar duke u fokusuar në shfrytëzimin e mirëfillët të tyre.

VI. Mbikëqyrja e shërbimeve të ofruara nga administrata e shërbimeve të sistemit prokurorial

Sekretariati synon ngritjen e llogaridhënies së administratës së Prokurorit të Shtetit dhe Këshillit përmes realizimit të vizitave dhe takimeve të rregullta dhe mbikëqyrjes sistematike të shërbimeve të kryera. Rrjedhimisht do të përgatiten raporte për Këshillin me të gjeturat, sifdat dhe rekomandimet lidhur me administratën e sistemit prokurorial.

3. Objektivat e Njësitit për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive

Njësi për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorive i Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin 2018 përcakton objektivat si në vijim:

- Mbështetja e vazhdueshme e Këshillit në administrimin e prokurorive;
- Mbështetja e vazhdueshme në procesin e rekrutimit, emërimit, riemërimit, transferimit, avancimit dhe vlerësimit të performancës të prokurorëve;
- Avancimi i sistemit të të dhënave statistikore;
- Avancimi i vlerësimit të nevojave për trajnime dhe koordinimit të pjesëmarrjes së prokurorëve në trajnim.

I. Mbështetja e vazhdueshme e Këshillit në administrimin e prokurorive

NJShPP do t'i ofrojë mbështetje Komisionit për administrimin e prokurorive në mbikëqyrjen e regjistrave të prokurorive, mënyrën e regjistrimit të lëndëve, numrin e lëndëve dhe personave dhe harmonizimin e raporteve statistikore të dërguara në Zyrën e Statistikave të NjShPP-së.

NjShPP do të përgatis raporte periodike dhe vjetore për punën e Prokurorit të Shtetit me fokus në kallëzimet lëndët penale të trashëguara, të pranuar në punë dhe ato të kryera nga ana e prokurorëve në të gjitha nivelet e sistemit prokurorial, departamentet përkatëse të prokurorive përfshirë dhe parashtruesit e këtyre kallëzimeve.

Po ashtu NjShPP, përgatit raport për veprat penale karakteristike, pjesë e mekanizmit përcjellës ndërinstitucional për harmonizimin e të dhënave statistikore, përfshirë veprat penale karakteristike.

NjShPP do të përgatis edhe analiza për numrin e nevojshëm të prokurorëve në sistemin prokurorial të Republikës së Kosovës. Kjo analizë hartohet duke marrë për bazë numrin e pranuar të lëndëve në Prokurorin e Shtetit, performancën e prokurorëve, arrijtet dhe mangësitë e konstatuara në punën e prokurorive gjatë viteve të fundit dhe domosdoshmërinë e përmirësimit në aspektin sasior dhe cilësor të performancës së prokurorisë.

II. Mbështetja e vazhdueshme në procesin e rekrutimit, emërimit, riemërimit, transferimit, avancimit dhe vlerësimit të performancës të prokurorëve

NjShPP ofron mbështetje administrative për Këshillin në procesin e rekrutimit, transferimit dhe avancimit të prokurorëve. Në këtë drejtim do të bëhen analiza dhe hartohen plane të veprimit për administrimin efikas të këtyre proceseve.



Përgatija e raporteve adekuate për këto procese si dhe rifreskimi i bazës së të dhënave do të jenë pjesë e aktiviteteve të këtij njësi.

III. Avancimi i sistemit të të dhënave statistikore

Hartimi i raporteve statistikore për punën e Prokurorit të Shtetit përbën një prej aktiviteteve kryesore të NjShPP. Andaj, në vitin 2018 do të punohet në zbatimin e sistemit të menaxhimit elektronik të lëndëve (TIK/SMIL). Deri në zbatimin e plotë të këtij sistemi, NjShPP do të vazhdojë të mirëmbajë dhe monitorojë funksionimin e sistemit të regjistrimit manual të lëndëve përmes regjistrave. Në veçanti do të punohet që të dhënat statistikore të përpunohen me kohë dhe të jenë pasqyrë reale për punën e prokurorive.

IV. Avancimi i vlerësimit të nevojave për trajnime dhe koordinimit të pjesëmarrjes së prokurorëve në trajnim

Ngritja e kapaciteteve profesionale dhe shkathtësive praktike të prokurorëve dhe personelit administrativ të sistemit prokurorial është prioritet i Këshillit edhe për vitin 2018. Që kjo të bëhet e mundur NjShPP do të angazhohet në vlerësimin e nevojave për trajnime, identifikimin e përfituesve të trajnimeve dhe koordinimin e pjesëmarrjes, në bashkëpunim të ngushtë me Akademinë e Drejtësisë dhe institucionet dhe partnerët tjerë që e mbështesin sistemin prokurorial në këtë proces.



Objektivat	Aktivitetet	Bartësi i aktivitetit	Afatet	Treguesit e realizimit të aktivitetit
1. Fuqizimi i administrimit, menaxhimit dhe llogaridhënies	Hartimi i strategisë së sistemit prokurorial 2019 -2021	<ul style="list-style-type: none"> - Këshilli - Grupi punues i themeluar nga Këshilli - Sekretariati - NJSHPP 	korrik – dhjetor	<ul style="list-style-type: none"> - Vendimet e Këshillit - Strategjia e miratuar
	Hartimi i strategisë për reduktimin e lëndëve të grumbulluara 2019 -2021	<ul style="list-style-type: none"> - Këshilli - Grupi punues i themeluar nga Këshilli - Sekretariati - NJSHPP 	janar – qershor	<ul style="list-style-type: none"> - Vendimet e Këshillit - Strategjia e miratuar
	Plotësim ndryshimi i Rregullores për NJSHPP	<ul style="list-style-type: none"> - Këshilli - Komisioni për çështje normative - Grupi punues i themeluar nga Këshilli - Sekretariati 	janar – dhjetor	Rregullorja
	Plotësim ndryshimi i Rregullores për organizimin e brendshëm dhe funksionimin e Prokurorit të Shtetit	<ul style="list-style-type: none"> - Këshilli - Komisioni për çështje normative - Sekretariati 	janar – dhjetor	Rregullorja
	Plotësim-ndryshimi i Rregullores për transferimin dhe avancimin e prokurorëve	<ul style="list-style-type: none"> - Këshilli - Komisioni për çështje normative - Sekretariati 	janar – dhjetor	Rregullorja
	Plotësim-ndryshimi i Rregullores për vlerësimin e performancës së prokurorëve	<ul style="list-style-type: none"> - Këshilli - Komisioni për çështje normative - Sekretariati 	janar – dhjetor	Rregullorja
	Hartimi i udhëzimit për dosje të prokurorëve	<ul style="list-style-type: none"> - Këshilli - Komisioni për çështje normative - Sekretariati 	janar – dhjetor	Udhëzues
Plotësimi- ndryshimi i rregullores	<ul style="list-style-type: none"> - Këshilli 	janar – dhjetor	Rregullorja	



për Këshillin Prokurorial të Kosovës	-Komisioni për çështje normative -Sekretariati		
Hartimi i Kodit të Etikës për Prokurorë	-Këshilli -Grupi punues i themeluar nga Këshilli		
Hartimi i udhëzimit për zbatimin e kodit të etikës	-Këshilli -Grupi punues	janar - dhjetor	Udhëzues
Hartimi i Rregullores për arkivim dhe dokumentim	-Këshilli -Komisioni për çështje normative -Grupi punues i themeluar nga Këshilli -Sekretariati	janar - dhjetor	Vendimi për themelimin të Grupit Punues Udhëzues
Plotësim ndryshimi i Rregullores për punën e Komisionit Disiplinor dhe procedurën disiplinore ndaj prokurorëve	-Këshilli -Komisioni për çështje normative -Komisioni Disiplinor -Sekretariati	janar - dhjetor	Rregullorja
Plotësim ndryshimi i Udhëzimit administrativ për përcaktimin e normës së prokurorëve	-Këshilli -Komisioni për çështje normative -Sekretariati	janar - dhjetor	Udhëzimi
Hartimi i udhëzimit të ri për përdorim të veturave në sistemin prokurorial	-Këshilli -Komisioni për çështje normative -Sekretariati	janar - dhjetor	Udhëzimi
Rishikimi i rregullores për KKLKE	-Këshilli -Komisioni për çështje normative -KKLKE	janar - dhjetor	Rregullorja
Hartimi i raportit vjetor për vitin 2017 për Këshillin	-Këshilli -Sekretariati -NJSHPP	janar - mars	Raporti vjetor
Hartimi i planit të punës dhe planit të veprimit për Këshillin për vitin 2019	-Këshilli -Sekretariati	tetor - dhjetor	Plani i punës dhe plani i veprimit



	<p>Plani orientues për trajnimin e prokurorëve për vitin 2019</p> <p>Raportet me shkrim të kryeprokurorëve</p> <p>Raportimet e Komisioneve të përhershme</p> <p>Raportimet e Komisioneve ad hoc</p> <p>Raportimi i Sekretariatit për gjendjen në sistemin prokurorial</p> <p>Takimet e rregullta të Këshillit</p> <p>Treza pune të Këshillit për vlerësimin e rrjedhës së proceseve të sistemit prokurorial</p> <p>Plotësimi i Këshillit me anëtarët jo prokurorë</p> <p>Zgjedhja e Drejtorit të NJSHPP</p>	<p>-NJSHPP</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Sekretariati</p> <p>-NJSHPP</p> <p>-Kryeprokurorët e prokurorëve</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Komisionet e përhershme të Këshillit</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Komisionet ad hoc të Këshillit</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Sekretariati i Këshillit</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Sekretariati</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Sekretariati</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Komisionet e përhershme</p> <p>-Sekretariati</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Komisioni</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Komisionet e përhershme</p> <p>-Sekretariati</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Komisioni</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Komisionet e përhershme</p> <p>-Sekretariati</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Komisioni për Çështje Normative</p> <p>-Sekretariati</p> <p>-Këshilli</p> <p>-Komisionet për Administrimin e</p>	<p>tetor - dhjetor</p> <p>janar - qershor korrik - dhjetor</p> <p>janar - qershor korrik - dhjetor</p> <p>janar - dhjetor</p> <p>janar - mars</p> <p>janar - dhjetor</p> <p>janar - qershor korrik - dhjetor</p> <p>janar - dhjetor</p> <p>janar - dhjetor</p>	<p>Plani i trajtimeve</p> <p>-Raportet</p> <p>-Procesverbalet</p> <p>-Raportet</p> <p>-Procesverbalet</p> <p>-Raportet</p> <p>-Procesverbalet</p> <p>-Raportet</p> <p>-Procesverbalet</p> <p>-Trankriptet</p> <p>-Vendimet</p> <p>-Raportet</p> <p>-Agjenda</p> <p>-Raporti</p> <p>- Plani</p> <p>- Procesverballi</p> <p>- Vendimi</p> <p>- Plani</p> <p>- Procesverballi</p> <p>- Raporti</p> <p>- Procesverballi</p> <p>- Transkripti</p> <p>- Raporti</p> <p>- Procesverballi</p>
<p>2. Mbikëqytja e sistemit prokurorial</p>				



3. Rritja e numrit të prokurorëve të shtetit	<p>prokurorive përfshirë regjistrat ndarjen e lëndëve dhe të dhënave statistikore</p> <p>Monitorimi i zbatimit të vendimeve për ndëshkimet dhe masat disiplinore</p> <p>Monitorimi i përgatitjes së kërkesës buxhetore dhe i procesit të rishikimit buxhetor</p> <p>Monitorimi i zbatimit të programeve trajnuese për prokurorë pas vlerësimit negativ të performancës së prokurorëve</p> <p>Mbikëqyrja e zbatimit të Procedurave Standarde të Veprimit për buxhet, financa, shërbime të përgjithshme, personel dhe teknologji administrative</p> <p>Ngritja e kapaciteteve profesionale të anëtarëve të komisioneve të përhershme</p> <p>Analiza e nevojave për rekrutimin e prokurorëve</p>	<p>Prokurorive - Sekretariati</p> <p>- Këshilli - Komisionet Disiplinor - Sekretariati</p> <p>- Këshilli - Komisionet për Buxhet dhe Financa - Sekretariati</p> <p>- Këshilli - Komisionet për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve - Sekretariati</p> <p>- Këshilli - Komisionet e përhershme - Sekretariati</p> <p>- Këshilli</p> <p>- Këshilli - ZKPSH - Sekretariati - N/SHPP - Kryeprokurorët e prokurorive</p> <p>- Këshilli - Prokurori i Shtetit - Sekretariati - N/SHPP</p> <p>- Këshilli - Prokurori i Shtetit</p>	<p>janar – dhjetor</p> <p>janar – dhjetor</p> <p>janar – dhjetor</p> <p>janar – dhjetor</p> <p>janar – dhjetor</p> <p>janar – dhjetor</p>	<p>- Raporti - Procesverbali</p> <p>- Raporti - Procesverbali</p> <p>- Raporti - Procesverbali</p> <p>- Raporti - Procesverbali</p> <p>- Raporti - Procesverbali</p> <p>- Raporti - Marrëveshjet - Memorandumet e bashkëpunimit</p> <p>- Raporti - Dokumenti analitik</p> <p>- Shtypja publike</p>	<p>- Lista me kandidatët - Raporti i provimit</p>
--	---	--	---	--	---



4. Zhvillimi i karrierës i prokurorëve	provimit për prokurorë	- Sekretariati - N/SHPP			
	Propozimi i listës së prokurorëve në Këshill	- Këshilli - Komisioni për rekrutim	qershor – dhjetor		- Raporti i komisionit rekrutues
	Miratimi i listës së prokurorëve të propozuar nga Komisioni për Rekrutim	- Këshilli	qershor – dhjetor		- Raporti i komisionit rekrutues
	Analizë e nevojave për avancim dhe transferim të prokurorëve	- Këshilli - Prokurori i Shtetit - Sekretariati - N/SHPP - Kryeprokurorët e prokurorëve	janar – qershor korrik – dhjetor		- Dokumenti analitik
	Shpallja për avancim dhe transferim të prokurorëve	- Këshilli - Prokurori i Shtetit - Sekretariati - N/SHPP	janar – qershor korrik – dhjetor		- Vendimi për shpallje - Shpallja
5. Forcimi i sistemit të vlerësimit të performancës së prokurorëve	Administrimi i punës për avancim dhe transferim të prokurorëve	- Këshilli - Komisioni për avancim dhe transferim	janar – qershor korrik – dhjetor		- Procesverbali - Formulari i vlerësimit - Lista e kandidatëve
	Propozimi i Komisionit për avancim dhe transferim	- Këshilli - Komisioni <i>ad hoc</i>	janar – qershor korrik – dhjetor		- Raporti i Komisionit - Vendimi i Këshillit
	Përgatitja e listave për vlerësim sipas atave dhe mënyrës së përcaktuar me ligj për vlerësim të performancës së prokurorëve	- Këshilli - Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve	janar – mars		- Plani i veprimit
Zbatimi i vlerësimit bazuar në listat për vlerësim	- Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve - N/SHPP	janar – dhjetor		- Lista për vlerësim	
Miratimi i raporteve për vlerësimin e performancës së prokurorëve	- Këshilli - Komisioni për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve - N/SHPP	janar – dhjetor		- Raporti - Procesverbali - Transkripti	



<p>6. Zhvillimi i mëtejshëm i sistemit të disiplinimit të prokurorëve</p>	<p>Trajtimi i rasteve disiplinore</p>	<p>- Komisioni Disiplinor</p>	<p>janar - dhjetor</p>	<p>- Plani i punës - Raportimet</p>
<p>7. Zbatimi i sistemit elektronik të menaxhimit të lëndëve</p>	<p>Mbiqëqyrja e rregullt e zbatimit të vendimeve disiplinore për prokurorë Krijimi i prototipit të modelit TIK/SMIL Instalimi i softuerit nëpër të gjitha prokuroritë</p>	<p>- Këshilli - Komisioni për Çështje normative - Komisioni Disiplinor - Këshilli - Sekretariati - Prokuroria Themelore në Ferizaj - Këshilli - Sekretariati - Prokuroria Themelore, PA, PSRK</p>	<p>janar - dhjetor janar - mars janar - dhjetor</p>	<p>- Demo prezantimi - Softueri</p>
<p>8. Krijimi i modelit për menaxhimin e proceseve në sistemin prokurorial</p>	<p>Funksionalizimi i TIK/SMIL Vendimet përkatëse, monitorimi dhe masat për zbatimin e TIK/SMIL Trajtimi i prokurorëve dhe stafit administrativ për përdorimin e TIK/SMIL</p>	<p>- Këshilli - Sekretariati - Prokuroria Themelore, PA, PSRK - Këshilli - Komisioni <i>ad hoc</i> për propozimin dhe monitorimin e masave - Këshilli - Sekretariati</p>	<p>janar - dhjetor janar - dhjetor janar - dhjetor</p>	<p>- Raportet - Procesverbalet - Transkriptet - Raportet - Procesverbalet - Agjendat - Raportet</p>
<p>9. Rritja e aftësive profesionale të prokurorëve dhe personelit</p>	<p>Krijimi i platformës për menaxhim të proceseve Zhvillimi i proceseve të buxhetit, financave dhe shërbimeve të përgjithshme Trajtimi i stafit</p>	<p>- Këshilli - Sekretariati i Këshillit - Administratorët - Këshilli - Sekretariati i Këshillit - Administratorët - Këshilli - Sekretariati i Këshillit - Administratorët</p>	<p>janar - dhjetor janar - dhjetor janar - dhjetor</p>	<p>- Raportet - Platforma funksionale - Raportet - Proceset e zhvilluara - Agjenda - Raportet</p>
<p>9. Rritja e aftësive profesionale të prokurorëve dhe personelit</p>	<p>Vlerësimi i nevojave për trajnim</p>	<p>- Këshilli - Prokurori i Shtetit - Sekretariati - N/SHPP</p>	<p>janar - qershor</p>	<p>- Formulari për vlerësimin e nevojave - Raporti me rekomandime</p>



administrativ	Hartimi i planit orientues për trajnimin e prokurorëve	- Këshilli - N/SHPP	janar - dhjetor	- Vendime - Raport
	Komunikimi i rregullt me Akademinë e Drejtësisë për trajnimin e vazhdueshëm	- Këshilli - Sekretariati - N/SHPP	janar - dhjetor	- Procesverbal - Raport
	Hartimi i udhëzuesve dhe standardeve për trajnime	- Këshilli - Sekretariati - N/SHPP	janar - dhjetor	- Procesverbal - Raport - Dokumentet e hartuara (udhëzuesit /standartet)
	Mbajtja e evidencës së trajnimeve dhe prokurorëve të trajnuar	- Këshilli - N/SHPP	janar - dhjetor	- Raport - Tabela e evidencës
	Mbiqyrtja e zbatimit të programeve trajnuese	- Këshilli - KVPP - Sekretariati - N/SHPP	janar - dhjetor	- Lista e pjesëmarrësve - Agjenda e trajnimit - Raportet - Rekomandimet e KVPP
	Zbatimi i Strategjisë për komunikim me publikun dhe median	- Këshilli - Prokurori i Shtetit - Sekretariati	janar - dhjetor	- Vendime - Raporte - Deklarata - Komunikata
	Rekrutimi i zyrtarëve për komunikim	- Këshilli - Sekretariati	janar - qershor	- Shpallja - Raport - Procesverbal
	Trajnimi i personave përgjegjës për zbatimin e strategjisë për komunikim	- Këshilli - Prokurori i Shtetit - Sekretariati	korrik-shtator	- Raporti - Procesverbal - Organigrami
	Hartimi i procedurave të brendshme për komunikim me publikun	- Këshilli - Prokurori i Shtetit - Sekretariati	janar - dhjetor	- Raport
	10. Avancimi i komunikimit me publikun dhe media			
11. Përmirësimi i infrastrukturës fizike dhe të teknologjisë informative dhe komunikimit	Renovimi i objekteve të PSRK dhe PTh në Prizren	- Këshilli - PSRK - Sekretariati	janar - qershor	- Plani i rinovimit
	Finalizimi i ndërtimit të objektit të Prokurorisë Themelore në Gjakovë	- Këshilli - Sekretariati	janar - dhjetor	- Plani i ndërtimit - Dokumentet e ndërtimit
	Sigurimi i ndërtesave për Këshill, ZKPSH dhe PTh në Mitrovicë	- Këshilli - Sekretariati	janar - dhjetor	- Sigurimi i Lokacioneve - Lejeve respektive - Planeve për rekrutim



12. Fuqizimi i bashkëpunimit me institucionet e vendit dhe ndërkombëtare	Sigurimi i pajisjeve të teknologjisë informative për punën në sistemin prokurorial (Këshill dhe Prokurorin e Shtetit)	- Këshilli - ZKPSH - Sekretariati	janar - dhjetor	- Dokumentet e ndërtimit - Raport - Procesverbal
	Takimet e rregullta me institucionet shtetërore, organizatat vendore dhe të huaja	- Këshilli - Komisionet e Përhershme të Këshillit - Sekretariati	janar - dhjetor	- Raport - Procesverbal
	Memorandume bashkëpunimi	- Këshilli	janar - dhjetor	-Memorandume - Raport - Procesverbale
	Takimet koordinuese me donatorë	- Këshilli - Sekretariati	janar - dhjetor	- Raport - Procesverbale
	Vizita studimore dhe programe shkëmbimi	- Raport - Procesverbale	janar - dhjetor	- Vendime - Raporte - Agjenda - Plane të vizitave dhe programeve
Sekretariati				
1. Fuqizimi i departamenteve të Sekretariatit të Këshillit	Zbatimi i procedurave standarde të veprimit	- Njësitë organizative	Janar - dhjetor	- Raportet e njësjive organizative - Raportet e auditimeve
	Hartimi i planeve të punes individuale të personelit 2019	- Njësitë organizative	Tetor - dhjetor	- Planetet e hartuara
	Zhvillimi i kapaciteteve të stafit	- Njësitë organizative - Divizionit i Burimeve Njerezore - Zyra e Trajtimeve	Janar - dhjetor	- Raportet e trajnimeve
	Zbatimi dhe monitorimi i planeve të punës së njësjive organizative të sekretariatit	- Zyra e drejtorit	Janar - dhjetor	- Raportet periodike



<p>2. Transferimi dhe avancimi i personelit administrativ</p>	<p>Hartimi i analizës për nevojat dhe kushet e avancimit dhe transferimit Proceset e avancimit dhe transferimit</p>	<p>- Sekretariati - Administratorët - Sekretariati - Administratorët</p>	<p>Janar - mars Janar - qershor</p>	<p>- Analiza e hartuar - Raportet e personelit të avancuar dhe transferuar - Plani i hartuar</p>
<p>3. Rekrutimi i personelit administrativ</p>	<p>Hartimi i planit të veprimit për rekrutim Zbatimi i rekrutimit</p>	<p>- Departamenti i Burimeve Njerëzore, Prokurim dhe Administratë - Departamenti i Burimeve Njerëzore, Prokurim dhe Administratë</p>	<p>Janar Janar - qershor</p>	<p>- Raporti për procesin e rekrutimit - Raportet për vlerësim të performancës</p>
<p>4. Vlerësimi i performancës së personelit administrativ</p>	<p>Vlerësimi i rregullt i performancës së personelit administrativ Vlerësimi i veçantë i personelit administrativ Rishikimi i formularëve të vlerësimit të performancës</p>	<p>- Udheheqësit e njësjive organizative të sekretariatit - Administratorët e prokurorive - Drejtori i Sekretariatit - Udheheqësit e njësjive organizative - Drejtori i Sekretariatit - Udheheqësit e njësjive organizative të sekretariatit - Administratorët e prokurorive</p>	<p>dhjetor Dhjetor Janar - dhjetor</p>	<p>- Agjendat e takimeve - Raportet për vlerësim të performancës - Agjendat e takimeve - Raportet për vlerësim të performancës</p>
<p>5. Rritja e efikasitetit në ofrimin e shërbimeve për Këshillin dhe Prokurorin e Shtetit</p>	<p>Zbatimi i planeve të punës dhe procedurave standarde të veprimit</p>	<p>- Drejtori i sekretariatit - Udheheqësit e njësjive organizative të sekretariatit - Administratorët e prokurorive</p>	<p>Janar - dhjetor</p>	<p>- Raportet periodike - Raportet e udheheqësve të njësjive organizative - Raportet e auditorëve</p>
<p>6. Fuqizimi i sistemit të sigurisë</p>	<p>Rishikimi i marrëveshjes së sigurisë me Policinë e Kosovës Hartimi i planit të sigurisë Caktimi i zyrtarit për siguri Monitorimi dhe raportet e rregullta të sigurisë</p>	<p>- Divizioni i Shërbimeve të Përgjithshme - Divizioni i Shërbimeve të Përgjithshme - Drejtori i Sekretariatit - Divizioni i Shërbimeve të Përgjithshme - Administratorët</p>	<p>Janar - mars Janar - mars Janar - qershor Janar - dhjetor</p>	<p>- Agjendat e takimeve</p>
<p>7. Mblidhja e shërbimeve të ofruara</p>	<p>Vizitat në prokurori</p>	<p>- Drejtori i sekretariatit - Udheheqësit e njësjive</p>	<p>Janar - dhjetor</p>	<p>- Agjendat e takimeve</p>



nga administrata e sistemit prokurorial	organizative të sekretariatit	- Raportet me rekomandime
Njësi për Shqyrtimin e Performancës		
<p>1. Mbështetja e vazhdueshme e Këshillit në administrimin e prokurorëve</p>	<p>Monitorimi i mbajtjes së regjistrave dhe ndarjes së lëndëve në Prokurorin e Shtetit</p> <p>Hartimi i raportit mbi gjendjen e regjistrave dhe ndarjen e lëndëve në Prokurorin e Shtetit</p> <p>Hartimi i raportit për Prokurorin e Shtetit 2017</p> <p>Hartimi i raportit të Mekanizmit Përcjellës 2017</p> <p>Hartimi i raporteve periodike për Prokurorin e Shtetit</p> <p>Hartimi i raporteve periodike të Mekanizmit Përcjellës</p> <p>Vendosja dhe mirëmbajtja e dosjeve të prokurorëve në bazën elektronike për dosjet e prokurorëve</p>	<p>-Agjenda -Raportet</p> <p>-Agjenda -Raportet</p> <p>-Raporti i publikuar</p> <p>-Raporti i publikuar</p> <p>-Raportet e publikuar</p> <p>-Raportet e publikuar</p> <p>-Të dhënat e vendosura</p>
<p>2. Mbështetja e vazhdueshme në procesin e rekrutimit, emërimit, rismërimit, transferimit, avancimit dhe vlerësimit të performancës të prokurorëve</p>	<p>-Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial/NJSHPP</p> <p>-Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial/NJSHPP</p> <p>-Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial/NJSHPP</p> <p>-Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial/NJSHPP</p> <p>-Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial/NJSHPP</p> <p>-Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial/NJSHPP</p> <p>Mbështetje në administrimin e procesit të vlerësimit të performancës</p> <p>Hartimi i listës së prokurorëve që do të vlerësohen gjatë vitit 2018</p> <p>Vizita e KVPP në zyrat e</p>	<p>-Agjenda -Raportet</p> <p>-Agjenda -Raportet</p> <p>-Agjenda -Raportet</p> <p>-Agjenda -Raportet</p> <p>-Agjenda -Raportet</p>



<p>3. Avancimi i sistemit të të dhënave statistikore</p>	<p>prokurorive</p> <p>Mirëmbajtja e dosjeve të prokurorëve në vlerësim të performancës</p> <p>Mbështetje në administrimin e procesit të transferimit dhe avancimit të prokurorëve</p> <p>Përpilimi i raporteve statistikore</p> <p>Harmonizimi i shënimeve statistikore në mes të prokurorive, gjykatave dhe agjencive për zbatimin e ligjit</p> <p>Monitorimi i zbatimit të bazës së të dhënave KrimKorr</p>	<p>dhe Verifikim Prokurorial/NJSHPP</p> <p>- Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial/NJSHPP</p> <p>- Zyra për Mbikëqyrje, Analitikë dhe Verifikim Prokurorial/NJSHPP</p> <p>- Zyra e Statistikave/NJSHPP</p> <p>- Zyra e Statistikave/NJSHPP</p> <p>- Zyra e Statistikave/NJSHPP</p>	<p>Janar - dhjetor</p> <p>Janar - dhjetor</p> <p>Janar - dhjetor</p> <p>Janar - dhjetor</p> <p>Janar - dhjetor</p> <p>Janar - dhjetor</p>	<p>- Raportet</p> <p>- databaza</p> <p>- Agjenda - Raportet</p> <p>- Raportet</p> <p>- Raportet</p> <p>- Raportet</p>
<p>4. Avancimi i vlerësimit të nevojave për trajnime dhe koordinimit të pjesëmarrjes së prokurorëve në trajnim</p>	<p>Vlerësimi i nevojave për trajnim të prokurorëve dhe personelit administrativ</p> <p>Koordinimi i pjesëmarrjes së prokurorëve në trajnime</p> <p>Vendosja e të dhënave për trajnime në bazën elektronike për dosjet e prokurorëve</p>	<p>- Zyra e Trajnimeve/NJSHPP</p> <p>- Zyra e Trajnimeve/NJSHPP</p> <p>- Zyra e Trajnimeve/NJSHPP</p> <p>- Zyra e Trajnimeve/NJSHPP</p>	<p>Tetor - dhjetor</p> <p>Janar - dhjetor</p> <p>Janar - dhjetor</p>	<p>- Raportet</p> <p>- Raportet</p> <p>- Raportet</p> <p>- Raportet</p>



www.kpk-rks.org